

VENDIM
Nr. 75, datë 29.4.2024

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “TEODORI” SHPK PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “ZALLI I
BULQIZËS” DHE HEC “TERNOVË”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 10, pikat 1, 3 dhe 7 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.4.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 950/1 prot., datë 26.4.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Teodori’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Zalli i Bulqizës’ dhe HEC ‘Ternovë’”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Teodori” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 950 prot., datë 16.4.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Zalli i Bulqizës” dhe HEC “Ternovë”, referuar Marrëveshjes së Koncesionit të miratuar me VKM-në nr. 556, datë 1.8.2003.

- Rezulton se me VKM-në nr. 556, datë 1.8.2003 është miratuar Marrëveshja e Koncesionit e formës “BOO” ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës dhe shoqërisë “Teodori” sh.p.k. për ndërtimin e hidrocentraleve në Ternovë dhe në Zall të Bulqizës.

- Marrëveshja e Koncesionit, e miratuar me vendimin nr. 556/2003, është nënshkruar ndërmjet MIE-s dhe shoqërisë “Teodori” sh.p.k. (në cilësinë e koncesionarit), ku ndër të tjera, në nenin 5 të saj, është parashikuar se *brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje, Koncesionari do të formojë shoqërinë koncesionare...*

- Pas aplikimit të bërë në ERE nga shoqëria koncesionare “Teodori 2003” sh.p.k., bordi i Komisionerëve të ERE-s, me vendimin nr. 83, datë 4.11.2009, ka vendosur të licencojë shoqërinë “Teodori 2003” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC i “Zall Bulqizës”, me fuqi 5.350 *mw* dhe HEC i “Ternovës” me fuqi 8.385 *mw*, me afat vlefshmërie 30 vjet.

- Rezulton se për ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet e përcaktuara në marrëveshjen e koncesionit të miratuar me VKM-në nr. 556/2003 është licencuar tashmë një shoqëri dhe ajo është “Teodori 2003” sh.p.k. Aplikuesi, shoqëria “Teodori” sh.p.k., nuk ka depozituar ndonjë miratim me shkrim të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për të kaluar të drejtën e operimit të hidrocentraleve “Ternovë” dhe “Zall i Bulqizës” te koncesionari, shoqëria “Teodori” sh.p.k.

- Përveç sa më sipër, rezulton se shoqëria “Teodori” sh.p.k. nuk ka kryer pagesën për aplikim, referuar përcaktimeve të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar.

- Për arsye se nuk është dokumentuar kryerja e pagesës për shqyrtimin e aplikimit dhe mungon dokumentacioni thelbësor që lidhet me miratimin e autoritetit shtetëror përgjegjës, në këtë rast MIE, që shoqëria “Teodori” sh.p.k. të operojë HEC “Ternovë” dhe “Zall i Bulqizës”, në referencë të Marrëveshjes së Koncesionit të formës “BOO”, të miratuar me VKM-në nr. 556, datë 1.8.2003, e

ndryshuar, dokumente këto që konsiderohen thelbësore për të vijuar me trajtimin dhe shqyrtimin e një aplikimi, vlerësohet mos fillimi i procedurës për këtë aplikim.

- Në mbështetje të përcaktimeve të nenit 10, pikës 7 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar, *nëse aplikuesi, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijeni e vendimit për mosfillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar dhe kryen pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të Rregullores, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm do të konsiderohet i vlefshëm për trajtimin e këtij aplikimi.*

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Teodori” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Zalli i Bulqizës” dhe HEC “Ternovë”.

2. Në rast se aplikuesi, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijeni e vendimit për mosfillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar dhe kryen pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të rregullores, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm do të konsiderohet i vlefshëm për trajtimin e këtij aplikimi.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Erjola Sadushi